



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

URDHËR

Nr.125, Datë 19.06. 2012

**“PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE NË PROKURORITË
PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “gj” i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar);

URDHËROJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Urdhrit

1. Ky urdhër ka për objekt përcaktimin e rregullave të njëjta për regjistrimin e të dhënave në regjistrat e Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe standartizimin e regjistrave duke përcaktuar modelin e tyre.

Neni 2

Llojet e regjistrave

1. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijohen këta regjistra, që pasqyrojnë veprimtarinë e prokurorisë në ushtrim të detyrave të saj procedurale:
 - a) Regjistri i veprave penale me autorë të njohur;
 - b) Regjistri i veprave penale me autorë të panjohur;
 - c) Regjistri i mosfillimit të procedimit penal;
 - ç) Regjistri i provave materiale;
 - d) Regjistri i përgjimeve të komunikimeve;
 - dh) Regjistri i ekzekutimit të vendimeve penale;
 - e) Regjistri i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;

- e) Regjistri i kallëzimeve anonime;
 - f) Regjistri i çështjeve për të cilat prokurori ka ngritur padi, thirret si person i tretë ose ndiqen me kërkesë në gjykatë;
 - g) Regjistri i masave të sigurimit.
2. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, sekretaria, regjistron veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës në:
- a) Regjistrin e korrespondencës;
 - b) Librin e dorëzimit;
 - c) Librin e dorëzimit të dokumentave nga sekretaria në sektor dhe anasjelltas.
3. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, sekretaria, evidencion veprimet për regjistrimin, shpërndarjen, shfrytëzimin, qarkullimin dhe shumëfishimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në këta regjistra:
- a) regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror";
 - b) regjistri i shumëfishimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror";
 - c) libri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror";
 - ç) libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror";
 - d) libri i regjistrimit të regjistrave për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

Neni 3 **Urdhri për regjistrim**

1. Drejtuesi i prokurorisë ose zëvendësdrejtuesi në prokuroritë e shkallës së parë ku ka funksion të tillë, urdhëron sipas rastit prokurorin ose punonjësin që mban regjistrat e përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të këtij Urdhri, të bëjë shënimet në regjistrin përkatës.
2. Kur procedimi transferohet nga një regjistër në një regjistër tjetër, prokurori urdhëron regjistrimin në regjistrin përkatës, duke treguar referencën e numrit të procedimit të regjistruar në regjistrin nga i cili transferohet. Dosja e mëparshme në këtë rast vendoset në një dosje të re.

KREU II

REGJISTRI I VEPRAVE PENALE ME AUTORË TË NJOHUR

Neni 4 **Modeli i Regjistrimit të Veprave Penale me Autorë të Njohur**

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë "Regjistrin e veprave penale me autorë të njohur", sipas modelit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

Neni 5
Indeksi Alfabetik

1. Regjistri i veprave penale me autorë të njohur, shoqërohet me Indeksën Alfabetik “Të dhënat për të pandehurin dhe viktimën/të dëmtuarin nga vepra penale”, që mbahet në format elektronik.
2. Në Indeksën Alfabetik “Të dhënat për të pandehurin dhe viktimën/të dëmtuarin nga vepra penale”, nuk regjistrohen të dhënat personale kur informacionet lidhur me to janë konfidenciale.

KREU III

REGJISTRI I VEPRAVE PENALE ME AUTORË TË PANJOHUR

Neni 6
Modeli i Regjistrimit të Veprave Penale me Autorë të Panjohur

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e veprave penale me autorë të panjohur”, sipas modelit nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU IV

REGJISTRI I MOSFILLIMIT TË PROCEDIMIT PENAL

Neni 7
Modeli i Regjistrimit të Mosfillimit të Procedimit Penal

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e mosfillimit të procedimit penal”, sipas modelit nr.3, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU V

REGJISTRI I PROVAVE MATERIALE

Neni 8
Modeli i Regjistrimit të Provave Materiale

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e provave materiale”, sipas modelit nr. 4, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU VI

REGJISTRI I PËRGJIMEVE TË KOMUNIKIMEVE

Neni 9

Modeli i Regjistrit të Përgjimeve të Komunikimeve

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e përgjimeve të komunikimeve”, sipas modelit nr. 5, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU VII

REGJISTRI I EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE PENALE

Neni 10

Modeli i Regjistrit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e ekzekutimit të vendimeve penale”, sipas modelit nr. 6, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU VIII

REGJISTRI I MARRËDHENIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

Neni 11

Modeli i Regjistrit të Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, sipas modelit nr. 7, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU IX

REGJISTRI I KALLËZIMEVE ANONIME

Neni 12

Modeli i regjistrit të kallëzimeve anonime

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e kallëzimeve anonime”, sipas modelit nr. 8, bashkëlidhur këtij urdhri.

Neni 13

Administrimi dhe Ruajta e Regjistrit të Kallëzimeve Anonime

1. Regjistri i kallëzimeve anonime duhet të administrohet në mënyrë të tillë që të ruhet konfidencialiteti i informacionit që përmban lidhur me dokumentet dhe të dhënat personale.

2. Regjistri i kallëzimeve anonime ruhet për një periudhë 5 vjeçare dhe më pas asgjësohet sipas rregullave të përcaktuara në Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

KREU X

REGJISTRI I ÇËSHTJEVE PËR TË CILAT PROKURORI KA NGRITUR PADI, THIRRET SI PERSON I TRETË OSE NDIQEN ME ANKIM NË GJYKATË

Neni 14

Modeli i Regjistrimit të Çështjeve për të Cilat Prokurori ka Ngritur Padi, Thirret si Person i Tretë ose Ndiqen me Ankim në Gjykatë

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e Çështjeve për të Cilat Prokurori ka Ngritur Padi, Thirret si Person i Tretë ose Ndiqen me Ankim në Gjykatë”, sipas modelit nr. 9, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU XI

REGJISTRI I MASAVE TË SIGURIMIT

Neni 15

Modeli i Regjistrimit të Masave të Sigurimit

1. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, krijojnë “Regjistrin e masave të sigurimit”, sipas modelit nr. 10, bashkëlidhur këtij urdhri.

KREU XII

REGJISTRAT E PROTOKOLLIT

Neni 16

Administrimi i Regjistrave të Protokollit

1. Regjistrat e përcaktuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij Urdhri, krijohen dhe administrohen sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, dalë në zbatim të këtij ligji.

KREU XIII

REGJISTRAT DHE LIBRAT E INFORMACIONIT “SEKRET SHETËTOR”

Neni 17

Regjistrat dhe Librat që Trajtojnë Informacionin “Sekret Shtetëror”

1. Regjistrat dhe librat që administrojnë informacionin “sekret shtetëror” të përcaktuar në pikën 3 të nenit 2 të këtij Urdhri, krijohen dhe administrohen në përputhje me rregulloren "Për punën me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.312, datë 16.3.2011

KREU XIV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Mbyllja e regjistrave

1. Regjistrat e përcaktuar në pikën 1 të Nenit 1 të këtij Urdhri, mbyllen në fund të vitit kalendarik.
2. Lëndët penale që mbesin të pazgjidhura në fund të vitit kalendarik mbarten në vitin kalendarik vijues dhe pasqyrohen në një libër të veçantë.
3. Mbyllja e librave të regjistrimit bëhet në atë mënyrë që në mbarim të vitit, në numrin e fundit të lëndës së regjistruar, futet një shënim që përmban: datën, muajin, vitin e mbylljes së regjistrit, numrin serik të lëndës së fundit të regjistruar për atë vit dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit.
4. Shënimi nënshkruhet nga zyrtari që administron regjistrin, nga drejtuesi i prokurorisë apo nga personi i autorizuar nga drejtuesi i prokurorisë.
5. Pas shënimit të lëndës së fundit të regjistruar nga viti kalendarik paraparak, regjistrimi lëndëve penale të reja për vitin aktual kalendarik fillon me regjistrimin numër “1”.

Neni 19

Korrigjimi i gabimeve në regjistrim

1. Gabimet në regjistra korrigjohen me një vijë të drejtë me stilolaps të thjeshtë mbi tekstin e regjistruar gabimisht, duke siguruar që teksti të mbetet i lexueshëm. Informacioni i saktë më pas shënohet në po atë fushë pa mbuluar tekstin që përmban gabimin.

Neni 20

Dispozita zbatuese

1. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Neni 21
Shfuqizime

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2006 “Për përgjimet”, pika 6 ”Regjistri i përgjimeve”, shfuqizohet.

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
2. Regjistrat e parashikuar në nenin 2, paragrafi 1, shkronjat “c”, “ç”, “e”, “ë” “f” dhe “g”, sipas modeleve bashkëlidhur këtij urdhri, vihen në përdorim më 1 Shtator 2012.
3. Regjistrat e parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, shkronjat “a”, “b”, “d” e “dh”, sipas modeleve bashkëlidhur këtij urdhri, vihen në përdorim më 1 Janar, 2013.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA

ERROR: syntaxerror
OFFENDING COMMAND: --nostringval--

STACK:

/Title
()
/Subject
(D:20120619152815+02'00')
/ModDate
()
/Keywords
(PDFCreator Version 0.9.5)
/Creator
(D:20120619152815+02'00')
/CreationDate
(ekanina)
/Author
-mark-